

Deklarata e Koalicionit të Qyteteve për të Drejtat Digjitale

Ne, qytetet e nënshkuara, vijmë formalisht së bashku për të formuar **Koalicionin e Qyteteve për të Drejtat Digjitale**, për të mbrojtur dhe ruajtur të drejtat e njeriut në internet, në nivel lokal dhe global.

Interneti është bërë një pjesë e pandashme e jetës sonë të përditshme. Gjithsesi, çdo ditë, kudo në botë ka raste të reja të abuzimit me të drejtat digjitale, të shpërdorimit, keqinformimit dhe përqendrimin të fuqisë: **liria e shprehjes** që censurohet; informacioni personal, duke përfshirë lëvizjet dhe komunikimet tona monitorohen, ndahen dhe shiten pa pëlqimin e qytetarëve; algoritmet “black box” po përdoren për të marrë vendimet; rrjetet sociale po përdoren si një mjet ngacmimi dhe urrejtjeje; **proceset demokratike** dhe opinioni publik po nënvlerësohen.

Si qytete, institucionet më të afërta demokratike me njerëzit, ne përkushtohemi për eliminimin e pengesave ndaj shfrytëzimit të mundësive teknologjike që përmirësojnë jetën e votuesve tanë, dhe për ofrimin e shërbimeve të besueshme, të sigurta dhe infrastrukturave që mbështesin komunitetet tona. Ne besojmë fort se **parimet e të drejtave të njeriut siç është privatësia, liria e shprehjes dhe demokracia** duhet të jenë të inkuorporuara që në dizejnimin e platformave digjitale, duke filluar me infrastruktura dhe shërbime digjitale të kontrolluara lokalisht.

Si një koalicion, dhe me mbështetjen e programit të United Nations Human Settlements ([UN-Habitat](#)), ne do ndajmë praktikat më të mira, do të mësojmë nga sfidat dhe sukseset e njeri tjetrit, do të koordinojmë nisma dhe aksione të përbashkëta. Të frymëzuar nga Koalicioni i të Drejtave dhe Parimeve të Internetit ([IRPC](#)) dhe puna e 300 palëve ndërkombëtare përgjatë dhjetë viteve të fundit, ne jemi të angazhuar për të ndjekur këto pesë parime:

1. Akses universal dhe i barabartë në Internet, si edhe aftësim digjital

Çdokush duhet të ketë akses të përballueshëm dhe të barabartë në shërbimet digjitale dhe në Internet, si edhe të ketë aftësitë e duhura digjitale për ta shfrytëzuar këtë akses dhe për të kapërcyer ndarjen digjitale.

2. Privatësia, mbrojtja e të dhënave dhe siguria

Çdokush duhet të ketë privatësi dhe kontroll mbi informacionin e tyre personal përmes mbrojtjes së të dhënave, si në vendet fizike edhe në ato virtuale, për të siguruar konfidencialitetin, sigurinë, dinjitetin dhe anonimitetin, si edhe sovranitetin mbi të dhënat e tyre, duke përfshirë të drejtën për të ditur se çfarë ndodh me të dhënat e tyre, kush i përdor ato dhe për çfarë qëllimi.

3. Trasparenca, besueshmëria dhe mos-diskriminimi i të dhënave, përmbajtjes dhe algoritmave

Çdokush duhet të ketë akses në një informacion të kuptueshëm dhe të saktë mbi sistemet teknologjike, algoritmike apo të inteligjencës artificiale të cilat impaktojnë jetën e tyre, si edhe duhet të ketë aftësinë për të ngritur pyetje dhe për të ndryshuar sisteme të padrejtë, të njëanshëm, apo diskriminues.

4. Demokracia me pjesëmarrje, diversiteti dhe përfshirja

Çdokush duhet të përfaqësohet në Internet, dhe në formë kolektive të angazhohet me qytetin përmes mundësive të hapura, përfshirëse dhe transparente për të formësuar teknologjitë e dizenuara për ta, duke përfshirë edhe menaxhimin e infrastrukturave tona digjitale dhe të të dhënave si një e mirë e përbashkët.

5. Standarde të hapura dhe etike të shërbimeve digjitale

Çdokush duhet të jetë në gjendje të përdorë teknologjitë e zgjedhura nga ata vet dhe të presë të njëjtat nivele interoperabiliteti, përfshirjeje dhe mundësish për shërbimet e tyre digjitale. Qytetet duhet të përcaktojnë infrastrukturën e tyre teknologjike, shërbimet dhe axhendën, përmes standardeve të hapura dhe etike të shërbimeve digjitale për tu siguruar se ato i përmbahen këtij parimi.